



## Kërkesat e konsumatorëve dhe udhëzimet për realizimin e tyre

*Të nderuar konsumatorë,*

Të gjithë Ju që jeni konsumatorë të KEDS Sh.A. mund të bëni kërkesa për shërbime të ndryshme, varësisht prej nevojës suaj. Stafi i KEDS sh.a. do të përpiqet që këto kërkesa t'i realizojë sa më shpejt, duke respektuar **Legjislacionin në fuqi**, në bazë të të cilit edhe funksionon KEDS-i.

Të gjitha kërkesat tuaja mund t'i paraqitni, duke plotësuar formularin në sportelet e shërbimit për konsumatorë. Mënyra tjetër është të dërgoni kërkesën tuaj me postë elektronike në adresën [contactcenter@keds-energy.com](mailto:contactcenter@keds-energy.com), përmes kutisë së sugjerimeve nëpër të gjitha distriktet/nëndistriktet apo përmes web-faqes [www.keds-energy.com](http://www.keds-energy.com) te fusha **IDEJA JUAJ**.

Më poshtë mund t'i gjeni disa prej llojeve të kërkesave të cilat mund t'i bëni në sportelet e shërbimit ndaj konsumatorëve si dhe udhëzimet për realizimin e tyre.

### **Regjistrimi i konsumatorit të ri në KEDS sh.a.**

Që të regjistroheni si konsumator i ri, ju duhet të paraqiteni në sportelet e Shërbimit për Konsumator dhe të plotësoni aplikacionin për lidhje të re. Me vete duhet të keni dokumentin identifikues. Konsumatorët komercialë duhet të sjellin edhe regjistrimin e biznesit. Nga ekipet

e KEDS-it do të bëhet pranimit teknik. Pastaj do të bëni kërkesën për kyçje dhe të nënshkruani kontratën për furnizim me energji elektrike. KEDS-i do ta bëjë lidhjen e pikës matëse të konsumatorit brenda 48 orëve prej pranimit të kërkesës për kyçje.

Pas kësaj, konsumatori do të ketë status legal dhe mund t'i gëzojë të gjitha të drejtat sipas kontratës së nënshkruar për furnizim me energji elektrike.

## **Ndërrimi i pronarit, respektivisht ndërrimi i emrit në kartelën e llogarisë**

Çdo ndërrim i të dhënave të shfrytëzuesit të energjisë elektrike brenda një objekti të pikës matëse, duhet të paraqitet në KEDS sh.a. Që do të thotë, se shfrytëzuesi i cili pretendon të jetë konsumator i ardhshëm, duhet të paraqitet në sportelet e KEDS sh.a. dhe të sjellë dokumentacionin si në vijim. Me rastin e shitblerjes së pronave, njëra ndër veprimet që konsumatori i ardhshëm duhet të bëjë, është edhe kontrollimi i detyrimeve të asaj pike matëse që ka ndaj KEDS sh.a. Pra, duhet të sigurohet kartela e transaksioneve në të cilën figuron se nuk ka asnjë borxh ndaj KEDS-it.

Për t'u bërë ndërrimi i emrit të konsumatorit, duhet të nënshkruhet kontrata e re për furnizim me energji elektrike. Ndërsa për ndërrimin e emrit nevojiten dokumentet si në vijim:

### **Kur ndërrohet pronari-shitblerje:**

- Kërkesa e konsumatorit për ndryshimin e emrit,
- Kopja e kontratës së shitblerjes e vërtetuar në gjyq,
- Dëftesë- pagesa që dëshmon pagesën e borxhit në tërësi.

### **Kur konsumatori kërkon ndryshimin e emrit me pjesëtar tjetër të familjes, nevojiten:**

- Kërkesa e konsumatorit për ndryshimin e emrit,
- Certifikata familjare dhe deklarata nga konsumatori paraprak (aktual), që me dëshirë kërkon të ndërrohet emri në kartelën e llogarisë,

- Dëftesë - pagesa që dëshmon pagesën e borxhit në tërësi.

**Kur konsumatori aktual lëshon objektin me qira, nevojiten:**

- Kërkesa e qiramarrësit për ndryshimin e emrit,
- Certifikata e pronësisë së objektit,
- Kopja e kontratës për dhënien e objektit me qira,
- Certifikata e biznesit e qiramarrësit nëse objekti lëshohet me qira për veprimtari komerciale,
- Dëftesë -pagesa që dëshmon pagesën e borxhit në tërësi.

**Kur konsumatori i evidentuar vdes, nevojiten:**

- Kërkesa e anëtarit të familjes së konsumatorit që ka vdekur për ndryshimin e emrit,
- Certifikata familjare dhe certifikata e vdekjes,
- Dëftesë- pagesa që dëshmon pagesën e borxhit në tërësi.

## **Ndërrimi i njehsorit, pikës matëse**

- Kërkesa me shkrim e konsumatorit për arsyen e ndërrimit të njehsorit. Formulari merret në sportelet e KEDS sh.a.
- Dëftesë- pagesa që dëshmon pagesën e borxhit në tërësi.

## **Mbyllja e llogarisë/ aktivizimi i llogarisë së mbyllur**

Derisa e keni shfrytëzuar energjinë elektrike në një objekt dhe keni qenë të regjistruar si konsumator, e ndërkohë më nuk e shfrytëzoni energjinë elektrike (nuk ju nevojitet), që të ndalet faturimi (vetëm taksa) më tutje dhe kartela të mbyllet, të pasivizohet, Ju duhet të veproni si më poshtë:

- Të vini në sportelet e Shërbimit ndaj Konsumatorëve, të bëni kërkesën me shkrim për pasivizim të pikës matëse dhe mbyllje të llogarisë, respektivisht për ndërprerje të furnizimit me energji elektrike,
- Pagesa e shërbimit për shkyçje,
- Dëftesë- pagesa që dëshmon pagesën e borxhit në tërësi.

## **Ndërrimi i grupit tarifor nga konsumatori familjar në konsumator komercial dhe anasjelltas**

Ndërrimi i grupit tarifor bëhet me kërkesën e konsumatorit që duhet të bëhet në sportelet e Shërbimit ndaj Konsumatorëve. Çdo ndërrim i veprimtarisë së objektit, duhet të pasqyrohet me ndërrimin e tarifave për energji. Ndërrimi i veprimtarisë nënkupton ndërrimin e statusit të konsumatorit nga ai i amvisërisë në komercial dhe anasjelltas, për shkak të rritjes apo zvogëlimit të fuqisë elektrike të angazhuar në objekt.

## **Kërkesë për kontrollimin e njehsorit**

Çdo konsumator mund të bëjë kërkesë për kontrollimin e pikës matëse. Për të realizuar këtë kërkesë konsumatori duhet të dorëzojë kërkesën me shkrim në sportelet e Shërbimit ndaj Konsumatorëve. Ekipet e autorizuara të KEDS-it do të bëjnë kontrollimin në afatin e duhur.

Ky shërbim është me pagesë dhe kartela e konsumatorit mund të ngarkohet me taksë 10 € plus TVSH.

## **Kërkesë për pëlqim elektro-energjetik parimor apo të përgjithshëm**

Konsumatori potencial para se të fillojë të ndërtojë një objekt në të cilën planifikon të shfrytëzojë energjinë elektrike, duhet të kërkojë pëlqimin parimor elektro-energjetik. Si ta

marrë lejen komunale për ndërtim duhet të kërkojë pëlqim elektro-energjetik për furnizim me energji elektrike.

Ekipet e KEDS-it në të dyja raste të do të dalin në vendin e ngjarjes dhe të japin përgjigjen se a mund të furnizohet konsumatori potencial apo jo me energji elektrike. Nëse po, atëherë duhet të jepet zgjidhja teknike se si mund të realizohet furnizimi.

### **Kërkesë për riplombim**

Çdo konsumator i cili për shkaqe të ndryshme ka heq pllombën nga pika matëse, është i obliguar që të lajmërojë në KEDS për ri-pllombimin e serishëm të pikës matëse. Kërkesa për riplombim bëhet në sportelet e Shërbimit ndaj Konsumatorëve dhe kartela e konsumatorit mund të ngarkohet me vlerën prej 10 € plus TVSH.

### **Kërkesa për rikyçje**

Konsumatori i cili është shkyçur nga rrjeti për shkaqe të ndryshme dhe kërkon të rikyçet në rrjetin e furnizimit me energji elektrike, KEDS sh.a. do ta rikyç objektin e tij jo më vonë se dy ditë, pas kërkesës së konsumatorit. Që nënkupton se konsumatori ka plotësuar kushtet për rikyçje, duke përfshirë rastet kur konsumatori ka paguar shumën e faturave sipas Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, ka nënshkruar një marrëveshje me kompaninë energjetike, ose ka kryer veprimin e kërkuar që ka qenë shkas për shkyçje.